



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË

Numri i lëndës: 2019:102684

Datë: 08.04.2024

Numri i dokumentit: 05558923

**C. nr. 670/2020**

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – DEGA NË KAMENICË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil**, përmes gjyqtarit Artan Abazi, në çështjen juridike kontestimore të paditësve Z. K., R. K., H. K., M. K., S. K., B. K., B.k., B. K. dhe M. K., që të gjithë nga ....., të cilët me autorizim i përfaqëson avokati Xhavit Krasniqi nga Prishtina, kundër të paditurit Firma “BVB Group” SHPK Gjilan, me drejtor M. J. nga ....., tani me adresë të panjohur, të cilën e përfaqëson përfaqësuesi i përkohëshëm avokati Enver Ajvazi nga Kamenica, me objekt kontesti për kompenzimin e dëmit materiale dhe jomaterial, me vlerë të kontestit prej 95,000.00 euro, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor dhe publik, në prezencën e të autorizuarit të palëve paditëse dhe të përfaqësuesit të përkohëshëm, më datën 13.02.2024 mori, ndërsa më datën 02.04.2024 përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I. APROVOHET PJESËRISHT** si e bazuar kërkesëpadia e paditësve Z.K., R. K., H. K., M. K., S. K., B. K., B. k., B. K. dhe M. K., që të gjithë nga ....., dhe **DETYROHET** e paditura Firma “BVB Group” SHPK Gjilan, me drejtor M. J. nga .... tani me adresë të panjohur, që në emër të kompenzimit të dëmit material dhe jomaterial, që paditësve – familjarëve, në emër të dhimbjeve shpirtërore të përjetuara, me rastin e vdekjes aksidentale, në punishten e të paditurës, e familjarit të tyre S. K., i cili ka ndërruar jetë, më datën 23.04.2012, t’ua paguaj, shumat si në vijim:

**Në emër të dëmit jomaterial për:**

- Z. K., shumën prej 10,000.00 (dhjetëmijë) euro,
- R. K., shumën prej 7,000.00 (shtatëmijë) euro,
- H.K., shumën prej 7,000.00 (shtatëmijë) euro,
- M.K., shumën prej 7,000.00 (shtatëmijë) euro,
- S. K., shumën prej 7,000.00 (shtatëmijë) euro,

- B.K., shumën prej 7,000.00 (shtatëmijë) euro,
- B. k., shumën prej 7,000.00 (shtatëmijë), euro,
- B. K. shumën prej 7,000.00 (shtatëmijë), euro,
- M. K.shumën prej 7,000.00 (shtatëmijë) euro,

**Në emër të dëmit material:**

- Për shpenzimet e shkaktuara të varrimit dhe të pamurit 1 (një) javor, shumën prej 1,000.00 (njëmijë) euro.

**II. DETYROHET** e paditura Firma “BVB Group” SHPK Gjilan, me drejtor M. J. nga ....., tani me adresë të panjohur, që t’ua paguaj shumat e gjykuara të gjithë paditësve, respektivisht shumën e përgjithshme prej 67,000.00 (gjashtëdhjetë e shtatëmijë) euro, si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, brenda afatit prej 15 ditësh, pas datës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të ekzekutimit të detyrueshëm.

**III. REFUZOHET** pjesa tjetër e kërkesëpadisë të të gjithë paditësve, në shumë prej 28,000.00 (njëzet e tetëmijë) euro, shumë kjo përtej shumave të gjykuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, e kërkuar në emër të kompensimit të dëmit jomaterial dhe material, respektivisht e kërkuar në emër të dhimbjeve shpirtërore, si dhe shpenzimeve të shkaktuara në emër të ngritjes së përmendores, me rastin e vdekjes aksidentale, në punishten e të paditurës, e familjarit të paditësve, tani të ndjerit S. K., i cili ka ndërruar jetë, më datën 23.04.2012, **TËRËSISHT E PABAZUAR.**

**IV. OBLIGOHEN** paditësit, që në emër të pagesës së taksës shtesë, për paraqitjen e padisë, konform vlerës së objektit të kontestit, prej 95,000.00 euro, të paguajnë edhe shumën prej 130.00 euro, brenda afatit prej 15 ditësh, pas datës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të ekzekutimit me detyrim.

**V. DETYROHET** e paditura Firma “BVB Group” SHPK Gjilan, me drejtor M.J. nga ....., tani me adresë të panjohur, që paditësve, t’ua kompenzoj shpenzimet e shkaktuara në këtë procedurë, në shumë të përgjithshme prej 3,701.00 (tremijë e shtatëqindë e një) euro, brenda afatit prej 15 ditësh, pas datës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të ekzekutimit me detyrim.

**A r s y e t i m**

**1. Rrijedha e procedurës**

Paditësit Z. K., R. K., H.K., M.K., S. K., B.K., B.k., B.K. dhe M.K., që të gjithë nga fshati ....., të cilët me autorizim i përfaqson avokati Xhavit Krasniqi nga Prishtin, në këtë gjykatë kanë parashtruar padi kundër të paditurit Firma “BVB Group” SHPK Gjilan, me drejtor M. J. nga ....., tani me adresë të panjohur, me objekt kontesti për kompenzimin e dëmit materiale dhe jomaterial, me vlerë të kontestit prej 95,000.00 euro.

Meqenëse të paditurit Firma “BVB Group” SHPK Gjilan, me drejtor M. J. nga ....., tani me adresë të panjohur, nuk ka qenë e mundur t’i gjindet adresa e saktë e vendbanimit apo vendqëndrimit, edhe pas tentimit të bërë nga gjykata që të njëjtit t’i gjindet adresa e vendbanimit apo vendqëndrimit, përmes institucioneve relevante, gjykata me propozimin e palëve paditëse e në kuptim të dispozitës së nenit 79 paragrafi 3, pika a), dhe nenit 81 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (tutje LPK-së), përmes Odës së Avokatëve të Kosovës, i’a ka caktuar përfaqësuesin e përkohshëm, të paditurit dhe atë Enver Ajvazi, avokat nga Kamenica.

Aktvendimi për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm është publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, më datën 29.08.2023.

## **2. Pretendimet e të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse**

I autorizuari i palëve paditëse, avokati Xhavit Krasniqi nga Prishtina, në seancën përgaditore dhe gjatë seancave të shqyrtimit kryesor, ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë, duke kërkuar nga gjykata që të gjithë paditësve të cekur si në hyrje të këtij Aktgjykimi, në emër të kompensimit të dëmit jomaterial, për dhimbjet shpirtërore, të pësuar nga paditësit dhe në emër të kompensimit të dëmit material, të shkaktuara me rastin e varrimit dhe pritjes së të pameve, si dhe të rregullimit të varrit të tani të ndjerit S. K., për shkak të vdekjes aksidentale të familjarit të ngushtë të tyre, respektivisht djalit – vëllaut të tyre, pasi që sipas të njëjtit, M. J. nga ....., tani me adresë të panjohur, pronar i Firmës “BVB Group” SHPK Gjilan, si përsosë i punimeve ndërtimore, duke vepruar nga pakujdesia ka vepruar kundër ligjit, me qka ka rezultuar me vdekjen aksidentale, në punishten e të paditurës, e tani të ndjerit S.K., dhe atë më datën 23.04.2012, (për më tepër si në aktgjykimin P.nr.519/2012, i datës 08.10.2013, i Gjykatës Themelore në Prishtinë). E duke i pasur parasysh gjitha këto, i ka propozuar gjykatës që t’i administroj të gjitha provat e propozuara si materiale dhe ato personale dhe pas administrimit të këtyre të obligohet e paditura që në emër të dhimbjeve shpirtërore të pësuar nga paditësit, të njëjtëve t’ua kompensojë në emër të dhimbjeve shpirtërore, si dhe në emër të kompensimit të dëmit material, për shpenzimet e varrimit dhe të pritjes së të pameve, si dhe të rregullimit të varrit të tani të ndjerit S. K., shumat e cekura si ne parashtresën për preczimin e padisë, të dorëzuar në këtë gjykatë më datën 02.02.2024. E pas të gjitha këtyre i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadija e paditësve të aprovohet në tërësi si e bazuar. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar në mënyrë të specifikuar si në parashtresën për paraqitjen e fjalës përfundimtare.

Përfaqësuesi i përkohshëm, Enver Ajvazi avokat nga Kamenica, në seancën përgaditore dhe gjatë seancave të shqyrtimit kryesor, ka deklaruar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve, duke theksuar se e njëjta nuk gjenë mbështetje në provat dhe faktet e bashkangjitura padisë dhe sipas të njëjtit me asnjë provë materiale paditësit nuk kanë arritur

që të vërtetojnë dëmet materiale dhe jomateriale, kinse të cilat i'a ka shkaktuar e paditura, dhe për këto arsye ka kërkuar nga gjykata që padia dhe kërkespadia e paditësve të refuzohet në tërësi si e pa bazuar në mungesë të provave. Por, megjithatë përfaqësuesi i përkohëshëm, Gjykatës i ka propozuar që në rast se gjen se e paditura është përgjegjëse për kompensimin e paditësve, në emër të dhimbjeve shpirtërore paditësve, të njëjtëvë t'u caktohet kompensimi në shumta të vogla në bazë të dispozitave ligjore dhe aktëve nënligjore, përmes se cilave caktohet vlera e kompensimit për këto lloje të dëmëve materiale dhe jo materiale. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar, dhe është pajtuar që t'a pranoj vetëm shumën e deponuar nga paditësit në këtë gjykatë, në emër të punës së përfaqësuesit të përkohëshëm.

### **3. Provat e administruara në shqyrtimin kryesor**

Gjykata për vlerësimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike dhe juridike, në këtë çështje juridike kontestimore në shqyrtimin kryesor i ka administruar këto prova materiale dhe personale: aktgjykimi P.nr.519/2012, i datës 08.10.2013, i Gjykatës Themelore në Prishtinë, i plotefuqishem, me datën 30.06.2014, certifikata e vdekjes, në emër të S. K., e datës 24.04.2012, e lëshuar nga Departamenti i mjekësisë ligjore, certifikatat e lindjes në emër të Z. V., R. K., H. K., M. K., S. K., B. K., B. K., B.K. dhe M. K., të lëshuara nga Zyra e Gjendjes Civile në Prishtinë, deklarata për bashkësi familjare, e datës 06.04.2021, e lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile në Prishtinë, ekspertiza psikiatrike, e datës 27.12.2023, e hartuar nga eksperti psikiatër, Dr.Q. R. nga Gjilani, dhe dëgjimi i palës paditëse R. K., në cilësi të palës.

Gjykata, pas analizimit dhe vlerësimit të provave materiale dhe atyre personale dhe vërtetimit të gjendjes faktike, në kuptim të dispozitës së nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha së bashku dhe ka gjetur se padia dhe kërkesëpadia e paditësve është pjesërisht e bazuar në ligj.

Gjykata, lidhur me faktet kontestuese në mes palëve ndërgjyqëse, është fokusuar që t'i vërtetoj në mënyrë të drejtë dhe objektive, dhe atë përmes këtyre provave materiale dhe personale si në vijim:

#### **3.1 Provat materiale**

Në bazë të aktgjykimit P.nr.519/2012, i datës 08.10.2013, i Gjykatës Themelore në Prishtinë, i plotefuqishem, me datën 30.06.2014, gjykata vërtetoi faktin se i padituri "BVB Group" SHPK Gjilan, me personin përgjegjës drejtor M. J. nga ....., tani me adresë të panjohur, është shpallur fajtor për veprë penale, Punime ndërtimore të kundërligjshme nga neni 294 paragrafi 4, lidhur me paragrafin 2 dhe 1 të KPRK-së, dhe të njëjtit i është shqiptuar dënim me burgim me kusht në kohëzgjatje prej dy viteve, e të cilin dënim me burgim i njëjti nuk do t'a mbajë, nëse gjatë periudhës verifikuese prej 3 vitesh, nuk kryen veprë tjetër penale. Madje gjykata përmes këtij aktgjykimi, e ka vërtetuar edhe faktin se M.J., pronari i firmës së lartëcekur tani të paditurës, e ka pranuar fajësinë për veprën për të cilën është shpallur fajtor.

Në bazë të certifikatës së vdekjes, në emër të S. K., nga babai I. K. dhe nëna Z.K., e datës 24.04.2012, e lëshuar nga Departamenti i mjekësisë ligjore, gjykata vërtetoi faktin se shkaku kryesor i vdekjes së të njëjtit ka qenë Polytrauma, ku ka pësuar thyerje të kafkës, legenit, më datë 23.04.2012, në vendin e ngjarjes në Hajvali, në Komunën e Prishtinës.

Në bazë të certifikatave të lindjes në emër të Z.V. e lindur më ....., në ....., nga babai A. V. dhe nëna A. V., R. K. i lindur më ....., në ....., nga babai I. K. dhe nëna Z. K. – V., H. K. e lindur më ....., në ....., nga babai I. K. dhe nëna Z.K. – V., M. K. e lindur më ....., në ....., nga babai I. K. dhe nëna Z. K.- V., S. K. e lindur më ....., në ....., nga babai I. K. dhe nëna Z. K. – V., B. K. e lindur më ....., në ....., nga babai I. K. dhe nëna Z. K. – V., B.K. i lindur më ....., në ....., nga babai I.z K. dhe nëna Z. K. – V., B.K. i lindur më ....., në ..... nga babai I.K. dhe nëna Z. K. - . dhe M. K. e lindur më ....., në ..... nga babai I. K. dhe nëna Z. K. - . të lëshuara nga ZGJC në Prishtinë, gjykata vërtetoi faktin se të njëjtit janë në gjini gjaku dhe atë si nënë, motra e vëllezër me tani të ndjerin S.K..

Në bazë të deklaratës për bashkësi familjare, me numër rendor 19/19001/1, e datës 06.04.2021, e lëshuar nga Zyra e Gjendjës Civile në Prishtinë, gjykata vërtetoi faktin se R. K., Z.K., H.K., M. K., S. K., B. k.u, B. K. dhe M. K., që të gjithë nga fshati H., Komuna e Prishtinës, janë në bashkësi familjare me të gjithë anëtarët e lartëcekur.

Në bazë të ekspertizës psikiatrike, të datës 27.12.2023, e hartuar nga eksperti psikiatër Dr.Qemajl Rexhepi nga Gjilani, gjykata vërtetoi faktin se eksperti psikiatër ka konstatuar se humbja e një anëtari të familjes është një humbje e madhe e posaçërisht kur ndodhë pas ndonjë aksidenti dhe nuk është pritur vdekja e tij apo e saj. Tutje, eksperti psikiatër ka konstatuar se shkalla e dhimbjes shpirtërore dhe e stresit, varet nga afërsia e personit, mosha, pjekuria dhe aspekti kulturor. Për më tepër nga ekspertiza psikiatrike është konstatuar se për prindërit (nënë) vdekja e fëmijës shkakton dhimbje të lartë shpirtërore për kulturën tonë. Eksperti psikiatër, ka konstatuar se fakti se në rastin konkret kemi të bëjmë me vdekje aksidentale që nuk është pritur fare, e bën dhimbjen shpirtërore të antarëve të familjes edhe me të madhe. Gjithashtu, eksperti psikiatër ka konstatuar se, vdekja aksidentale e Sabri Kryeziut, familjes së tij, i'a ka ndryshuar dinamikën familjare, jo vetëm në aspektin emocional, funksional por edhe vështirësi ekzistenciale, pasi në atë kohë ka qenë një nga mbajtësit kryesor të familjes.

### **3.2 Deklarata e palës paditëse**

Paditësi R.K. nga ....., në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 13.02.2024, ka deklaruar se në aksidentin ku ka vdekur vëllau i tij, S. K., ka ndodhur në Prishtinë, ku ka qenë duke punuar si punëtor krahu, në një ndërtesë në kompanin “BVB Group”, me pronar M. J., tutje ka theksuar se ky aksident ka ndodhur në prill të vitit 2012, ashtu që vëllau i tij ka rënë nga kati i 7, i ndërtesës, ku ka qenë duke punuar dhe ka vdekur pas një orë e gjysmë, në Spital në Prishtinë, si pasojë e lëndimve që ka pësuar. Po ashtu, ka theksuar se familja e tij ndjejnë dhimbje të madhe dhe se të njëjtëve nuk i është dhënë asnjë lloj kompensimi nga M. J.. Paditësi po ashtu,

ka theksuar se të gjithë paditësit në kohën kur ka ndërruar jetë vëllau i tyre, kanë qenë duke jetuar në një bashkësi familjare.

#### 4. Baza juridike

Në bazë të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, Ligji Nr. 04/L- 077, neni 136 paragrafi 1 është paraparë se *“Kush i shkakton tjetrit dëmin, ka për detyrë ta kompensoj, në qoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij”*. Në bazë të këtij principi pala përgjigjet për dëmin e shkaktuar me dashje dhe nga pakujdesia. Çështja e përgjegjësisë subjektive është rregulluar në bazë të nenit 140, të LMD-së është paraparë së *“Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia”*. Neni 153 paragrafi 1 të LMD-së, është paraparë së *“Përgjegjësia e personit juridik për dëmin e shkaktuar nga organi i tij. Personi juridik përgjigjet për dëmin të cilin organi i tij i'a shkakton personit të tretë gjatë ushtrimit ose lidhur me ushtrimin e funksioneve të tij”*, Neni 169 paragrafi 3 të LMD-së, është paraparë se *“Kur rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk është e mundur, apo kur gjykata konsideron se nuk është e domosdoshme që këtë ta bëjë personi përgjegjës, gjykata do të caktojë që ai t'ia paguajë të dëmtuarit shumën përkatëse në të holla në emër të shpërblimit të dëmit”*, Neni 172 paragrafi 1 të LMD-së, është paraprë se *“Në rast të vdekjes, të lëndimit trupor ose të dëmtimit të shëndetit, shpërblimi caktohet, sipas rregullës, në formë të rentës në të holla, për gjithë jetën ose për një kohë të caktuar”*. Neni 177 paragrafi 1 të LMD-së, është paraprë se *“Kush shkakton vdekjen e ndokujt ka për detyrë që t'i shpërblejë shpenzimet e zakonshme të varrimit të tij”*, Neni 184 paragrafi 1 dhe 2 të LMD-së, është paraparë se *“Në rast vdekjeje të ndonjë personi, gjykata mund t'ua caktojë anëtarëve të familjes së tij të ngushtë (bashkëshortit, fëmijët dhe prindërit) shpërblim të drejtë në të holla për dhembjen e tyre shpirtërore si dhe ky shpërblim mund t'u caktohet edhe vëllezërve dhe motrave në qoftë se ndërmjet tyre dhe personit të vdekur ka ekzistuar bashkëjetesa e vazhdueshme”*, Në bazë të Ligjit të punës nr. 03/ L-212, në nenin 42 paragrafi 2, 5 dhe 6, është paraprë se *“Punëdhënësi është i detyruar të sigurojë kushtet e nevojshme për mbrojtje në punë, me të cilat sigurohet mbrojtja e jetës dhe e shëndetit të të punësuarve në pajtim me ligjin. Punëdhënësi është i detyruar t'i zbatojë rregullat dhe procedurat e përgjithshme për mbrojtjen dhe sigurinë në punë, që janë të përcaktuara me Ligjin për Siguri në Punë, Mbrojtje të Shëndetit të të Punësuarve dhe Mbrojtjen e Ambientit të Punës. I punësuarit është i detyruar t'i përmbahet rregullave për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë, në mënyrë që mos të rrezikojë shëndetin dhe sigurinë e vet, si dhe sigurinë dhe shëndetin e punëtorëve të tjerë”*.

Andaj, duke marrë parasysh bazën ligjore të lartë cekur dhe gjendjen faktike të vërtetuar, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe e aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit, si dhe duke e pasur parasysh dispoziten e nenit 14, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, ku përcaktohet se *“Në procedurën kontestimore gjykata, në pikëpamje të ekzistimit të veprës penale dhe të përgjegjësisë penale të kryerësit, është e lidhur me aktgjykimin e formës së prerë të gjykatës penale, me të cilin i pandehuri është shpallur fajtor”*, e nga të gjitha këto, kjo gjykatë është bindur se pretendimet e paditësve janë të bazuara, pasi që pamëdyshje u vërtetua në bazë të provës materiale aktgjykimit P.nr.519/2012, të datës 08.10.2013, të Gjykatës Themelore në Prishtinë, i plotefuqishem, me datën 30.06.2014, i

padituri “BVB Group” SHPK Gjilan, me personin përgjegjës drejtor M. J. nga ....., tani me adresë të panjohur, është shpallur fajtor për vepër penale, Punime ndërtimore të kundërligjshme nga neni 294 paragrafi 4, lidhur me paragrafin 2 dhe 1 të KPRK-së, dhe të njëjtit i është shqiptuar dënim më burgim me kusht, në kohëzgjatje prej dy viteve, e të cilin dënim me burgim i njëjti nuk do t’u mbajë, nëse gjatë periudhës verifikuese prej 3 vitesh, nuk kryen vepër tjetër penale. Madje gjykata përmes këtij aktgjykimi, e ka vërtetuar edhe faktin se M.J., pronari i firmës së lartëcekur tani të paditurës, e ka pranuar fajësinë për veprën për të cilën është shpallur fajtor, e me të cilën provë materiale gjykata e ka vërtetuar bazën juridike të kërkesëpadsisë së paditësve, ndërsa në bazë të ekspertizës psikiatrike, të hartuar nga eksperti psikiater Dr.Qemajl Rexhepi nga Gjilani, të datës 27.12.2023, gjykata vërtetoi dëmin jomaterial, të cilin të gjithë paditësit, e kanë pësuar për shkak të vdekjes aksidentale, në punishten e të paditurës, e familjarit të tyre S. K., i cili ka ndërruar jetë, më datën 23.04.2012.

Duke u bazuar në dispozitën e nenit 7, të LPK-së, ku përcaktohet se *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”*, si dhe në dispozitën e nenit 319, paragrafi 1, të LPK-së, ku përcaktohet se *“Secila nga palët ndërgjyqjese ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta”*, gjykata vendosi sikurse në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, ngase në mungesë të provave materiale relevante, erdhi në përfundim se pjesa tjetër e kërkesëpadsisë së paditësve, në shumë prej 28,000.00 (njëzetë e tetëmijë) euro, shumë kjo përtej shumave të gjykuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, e kërkuar në emër të kompenzimit të dëmit material dhe jomaterial, respektivisht e kërkuar në emër të dhimbjeve shpirtërore, si dhe shpenzimeve të shkaktuara të varrimit dhe për ngritjen e përmendorës, me rastin e vdekjes aksidentale, në punishten e të paditurës, e familjarit të tyre S. K., i cili ka ndërruar jetë, më datën 23.04.2012, duhet të refuzohet në tërësi si e pabazuar, pasi që palët paditëse fillimisht nuk ka arritur që t’i prezentoj gjykatës prova konkrete rreth këtyre shpenzimeve të cilat të njëjtit i kanë kërkuar që t’iu kompensohen, e as gjatë shqyrtimit kryesor nuk kanë arritur që t’i provojnë pretendimet e tyre, se të njëjtëve i’u kanë shkaktuar edhe këto shpenzime.

##### **5. Vlerësimi përfundimtar i gjykatës**

Duke i marrë parasysh provat materiale dhe personale të administruara e të cekura si më lartë, si dhe dispozitat ligjore të lartëcekura, gjykata ka ardhur në përfundim dhe e ka vërtetuar faktin se kërkesëpadija e paditësve është në tërësi e bazuar në ligj, pasi që të njëjtit gjatë shqyrtimit kryesor përmes provave relevante dhe konkrete e kanë vërtetuar dhe e kanë bindur gjykatën se si pasojë e veprimeve të pakujdesshme të të paditurës, në punishtën e tij, aksidentalisht ka pësuar vdekje familjari I tyre (djali, respektivisht vëllau), S. K., dhe atë më datën 23.04.2012, në Prishtinë, dhe si pasojë e kësaj të gjithë paditësit kanë pësuar dhimbje të mëdha shpirtërore. Këtë fakt gjykata e ka vërtetuar në bazë të provës materiale të pakontestueshme, pra aktgjykimit P.nr.519/2012, të datës 08.10.2013, të Gjykatës Themelore në Prishtinë, i plotefuqishem, me datën 30.06.2014, përmes të cilit i padituri, personin përgjegjës, drejtor M. J. nga ....., tani me adresë të panjohur, i firmës “BVB Group” SHPK Gjilan, është shpallur fajtor për vepër penale, Punime ndërtimore të kundërligjshme nga neni 294 paragrafi 4, lidhur

me paragrafin 2 dhe 1 të KPRK-së, dhe të njëjtit i është shqiptuar dënim më burgim me kusht në kohëzgjatje prej dy viteve, e të cilin dënim me burgim i njëjti nuk do t'a mbajë, nëse gjatë periudhës verifikuese prej 3 vitesh, nuk kryen vepër tjetër penale. Madje gjykata përmes këtij aktgjykimi, e ka vërtetuar edhe faktin se M. J., pronari i firmës së lartëcekur tani të paditurës, e ka pranuar fajësinë për veprën për të cilën është shpallur fajtor, pasi si përfundim përgjegës me rastin e kryerjes së punimeve ndërtimore, nga pakujdesia ka vepruar kundër ligjit, me qka ka rezultuar me vdekjen aksidentale, në punishten e të paditurës, e tani të ndjerit S. K., dhe atë më datën 23.04.2012, e rrjedhimisht gjykata, bazën juridike të kërkesëpadisë së paditësve, e ka vërtetuar në bazë të aktgjykimit penal të formës së prerë të lartëcekur, ashtu që gjykata me rastin e vendosjes në këtë çështje juridike kontestimore, të njëjtin aktgjykim e mori për bazë dhe i'a fali besimin e plotë, ngase është i formës së prerë.

Në bazë të provave materiale të adminstruara, respektivisht ekspertizës psikiatrike, të hartuar nga eksperti psikiater Dr.Qemajl Rexhepi nga Gjilani, të datës 27.12.2023, gjykata vlerëson se kërkesa e paditësve, për kompensimin e shumave të kërkuara në emër të dëmit material dhe jomaterial, duhet t'i njihet si pjesërisht e bazuar në ligj, me ç'rastë në bazë të ekspertizës mjekësore psikiatrike të elaboruar si më lartë, gjykata e ka bazuar edhe lartësinë e kërkesëpadisë të paditësit dhe atë:

Në emër të dhimbjeve shpirtërore të pësuar nga paditësja Z. K., respektivisht nëna e tani të ndjerit S. K. dhe në emër të dhimbjeve shpirtërore të pësuar nga paditësit e tjerë, respektivisht motrat dhe vëllëzërit, e tani të ndjerit S. K., gjykata pjesërisht e ka aprovuar kërkesën e palëve paditëse dhe e ka caktuar shpërblimin për secilin veç e veç në shumat e cekura sin ë pikën I, të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke e vlerësuar si shpërblim të drejtë, e duke u nisur nga fakti se nga ekspertiza mjekësore e psikiatrisë, paditësit si pasojë vdekjes së familjarit të ngushtë të tyre, respektivisht djalit – vëllaut të tyre, aksidentalisht në vendin e punës, të elaboruar si më lartë, kanë përjetuar dhimbje të mëdha shpirtërore, pasi që vdekja e antatrit të ngushtë të familjarit të tyre ka qene vdekje aksidentale që nuk është pritur fare, e që ky fakt, sipas kësaj ekspertize psikiatrike, e bënë dhimbjen shpirtërore edhe më të lartë për të gjithë antarët e mbetur të familjes se tani të ndjerit S.K..

Ndërsa, Gjukata vendosi sikurse në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, dhe paditësve, i'a aprovoj pjesërisht kerkësën për kompensimin e dëmit material, si të bazuar, në emër të shpenzimeve të shkaktuara, për varrimin e familjarit të tyre të ngushtë, (djalit – vëllaut),tani të ndjerit S. K., si dhe në emër të pritjes së të pameve (ngushllimeve), në kohëzgjatje prej 1 jave, në shumë prej 1,000.00 (një mijë) euro, edhe përkundër faktit se paditësit nuk i kanë prezentuar gjykatës ndonjë faturë për shpenzimet e shkaktuara për këtë lloj të dëmit, por megjithatë Gjukata është bazuar në traditat, doket dhe zakonet, e shoqërisë tonë dhe pamëdyshje, është fakt botërisht i njohur se në rastin e varrimit të një familjari, domosdoshmërishtë shkaktohen edhe shpenzime monetare, e po ashtu domosdoshmërishtë shkaktohen shpenzime monetare edhe për ushqim, pije dhe gjësende tjera të nevojshme me rastin e pritjes se të pameve (ngushllimeve), andaj, edhe gjykata erdhi në përfundim se paditësve I'u takon kompenismi I pjesëshëm edhe për këtë lloj të dëmit material.



Ndërsa, sa I përket pjesës tjetër të refuzuar për kompensimin e dëmit material, në emër të shpenzimeve të shkaktuara, për varrimin e familjarit të tyre të ngushtë, (djalit – vëllaut), tani të ndjerit S. K., si dhe në emër të pritjes së të pameve (ngushllimeve), në kohëzgjatje prej 1 jave, në shumë prej 1,000.00 (një mijë) euro, gjykata erdhi në përfundim se kjo shumë e të hollave nuk u takon paditësve për t'iu kompensuar, ngase paditësit nuk I kanë ofruar gjykatës provë konkrete materiale se të njëjtit e kanë hargjuar shumën e të hollave prej 2,000.00 euro, me rastin e varrimit dhe pritje se të pameve të familjarit të tyre S. K., andaj dhe gjykata vendosi sikurse në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Duke u bazuar në dispozitat e cekura më lartë si dhe duke i vlerësuar të gjitha kriteret dhe masat për caktimin e lartësisë së shpërblimit të dëmit jomaterial, e posaçërisht duke marrë parasysh natyrën e dhimbjeve shpirtërore, për shkak të afërsisë familjare të paditësve, me tani të ndjerin S. K., i cili ka pësuar vdekje aksidentale, në punishten e të paditurës, e familjarit të tyre S. K., dhe ka ndërruar jetë, më datën 23.04.2012, në bazë të vlerësimit të ekspertizës mjekësore psikiatrike, të përshkruar si më lartë, gjykata aprovoj pjesërisht kërkesëpadinë e paditësve, në vlerat e shpërblimit të dëmit jomaterial, si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimit, duke e vlerësuar si shpërblim real, objektive dhe me bindje se ky shpërblim është në pajtueshmëri me natyrën dhe pasojat e dhimbjeve shpirtërore.

Gjykata konsideron se shumatat e gjykuara për të gjithë paditësit, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, paraqesin një satisfaksion moral dhe shpagim real për formën e dëmit të pësuar për shkak të dhimbjeve shpirtërore të paditësve, për shkak të vdekjes aksidentale, në punishten e të paditurës, e familjarit të tyre S.K., dhe ka ndërruar jetë, më datën 23.04.2012., duke marrë parasysh edhe kriteret e parapara me dispozitën e nenit 200, të Ligjit mbi Marrdhëniet e Detyrimeve, standardin jetësor të qytetarëve të Kosovës dhe praktikën e deri tanishme të gjykatave të Kosovës dhe Udhëzuesin për caktimin e kritereve orientuese dhe lartësisë së shpërblimit të drejtë në të holla të dëmit jo material, me numër 41/2023, të datës 27.02.2023, të nxjerrur nga Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës.

Gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, ngase pas vlerësimit të të gjitha provave të administruara dhe fakteve të vërtetuara, rezultoi se kërkesëpadia e paditësve, përtej shumës së aprovuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, është kërkesë e pabazë, pasi gjykata vlerësoi se shumatat e gjykuara janë të përshtatshme dhe në përputhje edhe me natyrën e dhimbjes shpirtërore që e kanë pësuar paditësit. Tutje Gjykata ka konstatuar se shumatat e aprovuara në emër të kompensimit, janë në harmoni me dëmet jomateriale dhe materiale të pësuar nga paditësit, si pasojë e vdekjes aksidentale, në punishten e të paditurës, e familjarit të tyre S. K., i cili ka ndërruar jetë, më datën 23.04.2012.,. Duke i marrë parasysh këto, gjykata e ka refuzuar pjesën tjetër të kërkesëpadisë së paditësve, në lidhje me dëmet jomateriale dhe materiale në lartësi prej 28,000.00 (njëzetë e tetëmijë) euro, shumë kjo përtej shumës së gjykuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi sepse nuk gjeti bazë ligjore e materiale për mbështetje të kërkesës së palëve paditëse, pasi që caktimi i shumave më të larta nuk do të ishte në proporcion me Udhëzuesin për caktimin e kritereve orientuese dhe lartësisë së shpërblimit të drejtë në të holla të dëmit jo material, me numër 41/2023, të datës 27.02.2023, të nxjerrur nga Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës.

Po ashtu, gjykata vendosi që pjesën tjetër të kërkesëpadisë, në shumë prej 2,000.00 euro të kërkuar nga paditësit, në emër të rregullimit të gurëve të varrit të tani të ndjerit S. K., t'a refuzoj si të pa bazuar, pasi që paditësit nuk i kanë paraqitur asnjë provë të vetme, relevante dhe të besueshme, respektivisht nuk i kanë paraqitur asnjë faturë, apo ndonje fotografi përmes të cilave do të vërtetohej se paditësit kanë shpenzuar mjete financiare, për rregullimin e varrit të tani të ndjerit S.K.. Andaj, u vendos sikurse në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata, vendosi sikurse në pikën IV, të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ nr.01/2017, për unifikimin e taksave gjyqësore dhe i obligoj paditësit, që në emër të pagesës së taksës shtesë, për paraqitjen e padisë, konform vlerës së objektit të kontestit, prej 95,000.00 euro, të paguajnë edhe shumën prej 130.00 euro, brenda afatit prej 15 ditësh, pas datës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të ekzekutimit me detyrim, pasi që paditësit me rastin e paraqitjes së padisë në emër të taksës gjyqësore kanë paguar vetëm shumën prej 20.00 euro.

#### **6. Shpenzimet e procedurës kontestimore**

Gjykata, lidhur me shpenzimet e procedurës kontestimore vendosi duke u mbështetur në nenin 449 dhe 452 paragrafi 1, të LPK-së, si dhe në bazë të Tarifës të Odës të Avokatëve të Kosovës, dhe e detyroj të paditurën, që paditësve, t'ua kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore, në shumë të përgjithshme prej 3,701.00 (tremijë e shtatëqindë e një) euro. Shpenzime këto të shkaktuara si në vijim; dhe atë në emër të përpilimit të padisë shumën prej 624.00 euro, në emër të pagesës së taksës gjyqësore për paraqitjen e padisë shumën prej 150.00 euro, në emër të ekspertizës mjeksore të psikiatrisë shumën prej 150.00 euro, në emër të përfaqësimit në 3 (tri) seanca gjyqësore, dhe atë për dy seanca veç e veç nga 811.00 euro, ndërsa për një seancë të shtyer 405.00 euro, në shumë prej 2,027 euro.

Duke u bazuar në thëniet dhe dispozitat materiale të lartëcekura, si dhe në dispozitën e nenit 143 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### **GJYKATA THEMELORE NË GJILAN - DEGA NË KAMENICË**

**Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil**

**C. nr. 670/2020, i datës 02.04.2024**

**G j y q t a r i**  
**Artan Abazi, d. v**

**KËSHILLË JURIDIKE:** kundër këtij aktgjykimi, palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh, pas datës së pranimit të të njëjtit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës, në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.

Numri i lëndës: 2019:102684  
Datë: 08.04.2024  
Numri i dokumentit: 05558923